

20251923932

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË ORGANIZATAVE TË INVALIDËVE

Neni 1

Në Ligjin e Organizatave të Invalidëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 89/08, 59/12, 23/13, 150/15, 27/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.317/20) në nenin 11, paragrafët 1 dhe 2 fjalët: “Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Neni 2

Në nenin 13, paragrafi 1, fjalët: “Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“Komisionin nga paragrafi 1 të këtij neni e formon Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, të përbërë nga tre anëtarë, njëri prej të cilëve është anëtar i Komisionit, me propozim të Këshillit Nacional të Organizatave të Invalidëve të Maqedonisë nga neni 26 të këtij ligji”.

Neni 3

Në nenin 14, paragrafi 1, fjalët: “Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Në paragrafin 2 fjalët: “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurën e Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë” zëvendësohen me fjalët: “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative, Procedurën e Marrëdhënieve të Punës dhe Mbikqyrjen Inspektuese në Shkallë të Dytë”.

Neni 4

Në nenin 16, paragrafet 1 dhe 3, fjalët: “Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Neni 5

Në nenin 21, paragrafet 1, 2 dhe 3 fjalët: “Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Neni 6

Në nenin 25, paragrafi 1, fjalët: “Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Neni 7

Në nenin 26, paragrafet 2 dhe 3, fjalët: “Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Neni 8

Në nenin 29, paragrafi 1, nënparagrafët 1 dhe 2 fjalët: “Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Neni 9

Në nenin 32, paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“Organizatave Nacionale të Invalidëve dorëzojnë raportin vjetor të punës me raport financiar në Këshillin Nacional, ndërsa Këshilli Nacional raportin ia dorëzon Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe donatorëve të mjeteve financiare”.

Neni 10

Në nenin 35, paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“Mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e funksionimit dhe përmbushjes së dispozitave të këtij ligji dhe Ligjit të Shoqatave dhe Fondacioneve të qytetarëve mbi Organizatën e Invalidëve, Organizatën Nacionale të Invalidëve dhe Këshillin Nacional të Organizatave të Invalidëve, kryhet nga shërbimi i inspektimit pranë Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, ndërsa mbikëqyrjen e punëve financiare e kryen Ministria e Financave, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe Auditori i Shtetit për Çështjet Financiare”.

Neni 11

Në nenin 36, paragrafi 3, fjalët: “Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Neni 12

Në nenin 36-a, paragrafi 10, fjalët: “Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Neni 13

Në nenin 36-b, paragrafi 9 ndryshohet si vijon:

“Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për vërejtjet e shqiptuara”.

Neni 14

Komisioni Ligjvënës-Juridik i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është i autorizuar të përpilojë tekst të rafinuar të Ligjit të Organizatave të Invalidëve.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e tetë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.